

UDHËZUES PËR OPERATORËT

RREGULLIMI I TARIFAVE TË ROAMINGUT NË MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE VENDEVE TË BALLKANIT PËRENDIMOR

(Zbatimi i Vendimit të ARKEP Nr.1393 për rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile në mes Republikës së Kosovës dhe Ballkanit Përendimor)

Janar, 2020

1. Hyrje

- 1.1 Ky udhëzues ka për qëllim t'i informoj në mënyrë më të detajuar operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile lidhur me tarifat e rregulluara të roamingut në mes Republikës së Kosovës dhe vendeve të Ballkanit Përendimor (tutje referuar si - BP).
- 1.2 Tarifat e rregulluara të roamingut, të cilat aplikohen nga data 01 Korrik 2019 vlejnë për vendet e BP si në vijim: Shqipëri, Maqedoni Veriore, Malin e Zi, Bosne dhe Hercegovonën si dhe Serbinë.
- 1.3 Ky udhëzues përfshinë sqarimet e nevojshme si për tarifat me pakicë (Retail) ashtu dhe për ato me shumicë (Wholesale).
- 1.4 Vendimi nr.1393 i ARKEP për rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile në mes Republikës së Kosovës dhe Ballkanit Përendimor (tutje referuar si – Vendimi për Roamingun), i cili përfshinë tarifat me pakicë ashtu edhe për ato me shumicë, aplikohet ndaj të gjitha ndërmarrjeve, të cilat ofrojnë shërbime të roamingut për konsumatorët në roaming.
- 1.5 Ky udhëzues është përgatitur duke iu referuar dokumentit të BEREC, “*BoR (16) 34 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2120/2015 (Excluding Articles 3, 4 and 5 on wholesale access and separate sale of ser-vices)*”, duke i përshtatur në kontekstin e marrëveshjes rajonale të roamingut (RRA WB6), dhe shërbejnë kryesisht për zbatimin e fazës tranzitore të roamingut (Rome Like at Home Plus - RLAH+).
- 1.6 Sa i përket modelit RLAH (Rome Like at Home), respektivisht aplikimit të “Fair Use Policy” (FUP), udhëzimet e nevojshme do të jepen në gjysmën e dytë të vitit 2020.

2. Shërbimet me pakicë

Shërbimet e Rregulluara të Roamingut

- 2.1 Thirrjet e rregulluara të roamingut në përputhje me Vendimin për Roamingun i referohen thirrjeve të rregulluara të roamingut të bëra ose të marra nga/në rrjetin e vizituar (d.m.th. një rrjet i vendosur në një Shtet i BP, i cili nuk është shteti amë) nga/në një Shtet i BP, d.m.th.-thirrje brenda BP, p.sh. kur një konsumator kosovar është në roaming në Shqipëri dhe telefonon dikë në Malin e Zi. Ky definicion zbatohet në mënyrë analoge për shërbimet e mesazheve SMS të rregulluara të roamingut sipas Vendimit për Roamingun.
- 2.2 Shërbimet e rregulluara të roamingut të të dhënave, janë ato shërbime të të dhënave të konsumuara nga një konsumator në roaming përderisa është i lidhur me një rrjet të vizituar. Shërbimi i rregulluar i të dhënave në roaming zbatohet pavarësisht teknologjisë, e cila përdoret nga rrjeti mobil i komunikimeve elektronike (p.sh. GPRS, UMTS, LTE, etj.). Sidoqoftë, shërbimet e

rregulluara të roaming të të dhënave, si rregull i përgjithshëm, nuk përfshijnë shërbime të ofruara përmes një lidhje Wi-Fi, përveç nëse, për shembull, lidhja Wi-Fi në fjalë menaxhohet dhe/ose përdoret nga një operatori mobil për të mundësuar ose rritur kapacitetin e disponueshmërisë së rrjetit.

Çmimet kombëtare me pakicë si bazë për tarifën e Rregulluara të Roamingut

- 2.3 Neni 2 (2) (r) i Rregullores së BE-së për Roamingun¹ e përcakton çmimin kombëtar (brendshëm) të shitjes me pakicë (domestic retail price) si tarifa kombëtare me pakicë për njësi të ofruesit të shërbimit roaming të zbatueshme për thirrjet e kryera dhe SMS-të e dërguara (të origjinuara dhe terminuara në rrjete të ndryshme të komunikimit publik brenda të njëjtit shtet anëtar) dhe për të dhënat e konsumuara nga konsumatori.
- 2.4 Në rast se nuk ka asnjë tarifë kombëtare me pakicë për njësi, çmimi i brendshëm me pakicë duhet të konsiderohet të jetë i njëjti mekanizëm tarifor me atë të zbatuar për konsumatorin për thirrjet e kryera dhe SMS-të e dërguara (hyrëse dhe dalje në rrjete të ndryshme të komunikimit publik brenda të njëjtit shtet anëtar) dhe të dhënat e konsumuara shtetin anëtar të konsumatorit;
- 2.5 Në rast se ekzistojnë dy çmime të ndryshme “*off-net*” në një parapagim, operatorët duhet të zbatojnë mekanizmin e njëjtë të tarifimit si në shtetin e atij konsumatori.
- 2.6 Në rastin kur nuk ka çmim specifik kombëtar me pakicë (p sh. Planet tarifore të pakufizuara ose pako/bundle ose tarifën e brendshme që nuk përfshijnë të dhëna/data), çmimi i brendshëm me pakicë duhet të konsiderohet të jetë mekanizëm i njëjtë tarifimi sikur konsumatori të jetë duke shfrytëzuar planin tarifor në vendin e tij.
- 2.7 Për tarifën me paketa/bundle (tarifën me sasi të caktuar volumi), operatorët duhet të aplikojnë të njëjtin mekanizëm tarifimi si në shtetin e tyre dhe duhet të zbriten nga lejimi i vëllimit të brendshëm. Nëse ajo pao është konsumuar (brenda shtetit ose në roaming), atëherë çmimi kombëtar me pakicë do të jetë tarifa jashtë pakos.

Periudha tranzitore (RLAH+) dhe RLAH

- 2.8 Gjatë periudhës tranzitore, përkatësisht nga data 01 Korrik 2019 deri më datë 30 Qershor 2021, ofruesit e Shërbimeve të telefonisë mobile në Republikën e Kosovës mund të aplikojnë tarifën shtesë për parapaguesit e tyre krahas çmimit kombëtar (domestic price) të shitjes me pakicë për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut me vendet e BP.
- 2.9 Tarifën shtesë, të cilat mund të aplikohen nga operatorët në asnjë rast nuk duhet të jenë më të larta se ato të specifikuara në tabelën në vijim (Tarifën pa TVSH):

¹ Rregulloren e BE-së për Roamingun Nr. 531/2012 (BE) të ndryshuar me Rregulloren Nr. 2015/2120

Tabela 1: Tarifatat maksimale shitesë dhe tarifa totale maksimale me pakicë të operatorëve të Republikës së Kosovës për roamingun në vendet e BP sipas modelit RLAH+ (Pa TVSH).

TARIFA SHITESË MAKSIMALE – MODELI RLAH+	
Thirrjet e realizuara	0.05€/minut
Thirrjet e pranuar	0.04€/minut (0.025 nga 01 Korriku 2020)
SMS të dërguar	0.02€/SMS
Transferim i të dhënave (Internet)	25€/GB (15€/GB nga 01 Korriku 2020) 10€/GB (8.5€/GB nga 01 Korriku 2020 - Shqipëri)

- 2.10 Shuma e çmimit të aplikuar me pakicë, e cila përfshinë tarifën kombëtare dhe tarifën shitesë për shërbimet e rregulluara të Roamingut të specifikuar në paragrafin 2) të këtij Vendimi nuk duhet të kalojë vlerën (pa TVSH): 0.19€/min për thirrjet e realizuara, 0.06€ për SMS e dërguar dhe 0.18 € për MB e shfrytëzuar. Në rast se çmimi me pakicë në nivel kombëtar është më i lartë se çmimi maksimal roaming me pakicë, atëherë do të aplikohet çmimi maksimal roaming me pakicë edhe në rast se asnjë tarifë shitesë nuk aplikohet.
- 2.11 Ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile nuk duhet të aplikojnë tarifë shitesë për SMS e pranuar dhe voicemail nga parapaguesit gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të Roamingut. Sidoqoftë, ndëgjimi i "Voicemail" mund të jetë objekt i tarifimit nga operatori.
- 2.12 Nga data 01 Korrik 2021, parapaguesit gjatë qëndrimit në njërin nga vendet e BP nuk do të paguajnë asnjë tarifë shitesë për shërbimet e rregulluara të roamingut (thirrjet e realizuara ose pranuar, SMS të dërguar dhe të dhëna/Data të shfrytëzuar), përveç tarifës e cila aplikohet në Republikën e Kosovës (Rome Like at Home - RLAH). Kjo do të thotë se ofruesit e shërbimit roaming nuk mund të shtojnë asnjë tarifë shitesë direkte ose indirekte për të mundësuar roamingun në shtetet e BP.
- 2.13 Sidoqoftë, pas datës 01 Korrik 2021 operatorët mund të aplikojnë tarifa shitesë për parapaguesit nëse janë të autorizuar për një veprim të tillë ose në rastin kur niveli i konsumimit të të dhënave e kalon volumin e lejuar (Fair use volume limit), i cili është i specifikuar në kontratën me parapaguesin.
- 2.14 Tarifatat shitesë maksimale që mund të aplikohen në modelin RLAH janë:

Tabela 2: Tarifatat maksimale shitesë sipas modelit RLAH (pa TVSH)

TARIFA SHITESË MAKSIMALE – MODELI RLAH	
Thirrjet e realizuara	0.032€/minut
Thirrjet e pranuar	0.016€/minut
SMS të dërguar	0.01€/SMS
Transferim i të dhënave (Internet)	7.7€/GB ²

² Kjo tarifë do të zbrisë në mënyrë graduale: 6€/GB më datë 01 Janar 2022; 4.5€/GB më datë 01 Janar 2023; 3.5€/GB më datë 01 Janar 2024; 3€/GB më datë 01 Janar 2025; dhe 2.5€/GB më datë 01 Janar 2026;

- 2.15 Planet tarifore RLAH (Roam Like at Home) përfshijnë shërbimet e Roamingut në pakot vendore (Domestic bundle). RLAH+ lejon ofruesin e shërbimeve roaming që të aplikoj një tarifë shtesë (surcharge) përveç çmimit kombëtar të shitjes me pakicë gjatë periudhës transitore.
- 2.16 Ofruesit e shërbimeve duhet të zbatojnë tarifën e rregulluar të roamingut për parapaguesit ekzistues dhe ata të rinjë në mënyrë automatike. Pavarësisht nga kjo, Ofruesit e roamingut mund të ofrojnë dhe parapaguesit roaming mund të zgjedhin me vetëdije, një tarifë roaming të ndryshme nga ato të rregulluara sipas modelit RLAH dhe RLAH+, në bazë të cilës parapaguesit roaming përfitojnë nga një tarifë për shërbimet roaming të ndryshme nga ato të rregulluara në mungesë të një zgjedhjeje të tillë. Ofruesi i roamingut duhet t'i kujtojë/informojë këtyre parapaguesve roaming për natyrën e avantazheve roaming që ata po heqin dorë për shkak të zgjedhjes së tyre.
- 2.17 Çdo parapagues në roaming mundet në çdo kohë të kërkojë të kalojë në ose nga një tarifë e caktuar në përputhje me përcaktimet për RLAH dhe RLAH+. Kur parapaguesit roaming me vetëdije zgjedhin të kalojnë ose kthehen në një tarifë të caktuar në përputhje me RLAH dhe RLAH+, çdo kalim duhet të bëhet pa pagesë brenda një (1) dite pune nga marrja e kërkesës dhe nuk do të kërkojë kushte ose kufizime që kanë të bëjnë me elementet e abonimit, përveç roamingut. Ofruesit e roamingut mund të vonojnë kalimin derisa tarifa e mëparshme e roamingut të jetë efektive për një periudhë minimale të përcaktuar jo më shumë se dy (2) muaj.
- 2.18 Operatorëve u lejohet që të ofrojnë pako vendore, në të cilat nuk është i përfshirë shërbimi i roamingut (domestic only). Operatorët duhet të sigurohen se parapaguesit janë të njoftuar se me zgjedhjen e këtyre pakove, gjatë qëndrimit në njërin nga vendet e BP nuk do të kenë qasje në shërbimet e roamingut.

Tarifat fikse periodike

- 2.19 Operatorët kanë të drejtë që të ofrojnë paketa tarifore roaming me një tarifë fikse ditore ose çdo tarifë tjetër fikse roaming periodike dhe që përmbajnë një volum të caktuar të shërbimeve roaming të rregulluara në BP. Këto paketa duhet të jenë si një opsion/alternative për parapaguesit e tyre gjatë periudhës tranzitore përveç tarifave të rregulluara roaming. Kjo do të thotë që këto tarifa periodike fikse roaming nuk mund të jenë opsioni i vetëm tarifor i disponueshëm për parapaguesit roaming.
- 2.20 Një tarifë fikse periodike roaming në përputhje me përcaktimet për RLAH+, mund të mos konsiderohet si tarifë alternative, me kushtin që konsumi i plotë i njësive të përfshira në paketë (pagesën fikse) rezulton në një tarifë për njësi të shërbimeve të rregulluara në roaming (thirrje, SMS dhe data), e cila nuk tejkalon shumën e tarifës vendase dhe me pakicë me tarifën shtesë maksimale sipas përcaktimeve të RLAH+. Për të bërë këtë vlerësim duhet të kryhen llogaritjet përkatëse nëse tarifa fikse është në përputhje me rregullat për RLAH+ (Paragrafi 17 i Udhërrëfyesit të BEREC 2016).

SHEMBULL: Nga 1 Korrik 2019 deri më 30 qershor 2020, një paketë tarifore roaming periodike fikse që përfshin 25 minuta thirrje dalëse, 25 minuta thirrje hyrëse, 25 mesazhe SMS dhe 25 MB mund të tarifohet me një tarifë ekstra maksimale prej 3.375 euro (25 minuta * 0.05 euro + 25 minuta thirrje të marra * 0.04 euro + 25 SMS * 0.02 euro + 25 MB * 0.025 euro) mbi tarifën e paketës brenda vendit. Për tarifatat e paketave bundle, kjo do të thotë një tarifë fikse roaming ditore deri në 3.375 euro për sasi të caktuara apo më të mëdha do të ishte në përputhje me fazën e parë të RLAH+ me BP. Për tarifatat vendase të matur për njësi, një tarifë fikse periodike roaming prej 3.375 euro plus çmimin brenda vendit retail për 25 minuta thirrje dalëse, 25 minuta thirrje hyrëse, 25 mesazhe SMS dhe 25 MB konsiderohet në përputhje me RLAH+.

Tarifatat alternative

- 2.21 Tarifatat alternative janë ato tarifa, të cilat mund të ofrohen përveç tarifave të rregulluara të roamingut të përcaktuara me Vendimin e ARKEP.
- 2.22 Operatorët kanë të drejtë që të ofrojnë paketa alternative roaming me BP, por tarifatat dhe tarifimi default/automatik do jetë sipas përcaktimeve të caktuara më sipër (RLAH dhe RLAH+). Nëse parapaguesi dëshiron një paketë alternative roaming ai duhet të informohet nga operatori për mundësinë që ka për të konsumuar sipas RLAH apo RLAH+. Pra zgjedhja e parapaguesit duhet të jetë me vetëdije në kushte që ka informacion të plotë për tarifatat sipas RLAH dhe RLAH+. Informimi për tarifatat e rregulluara roaming me BP mund të kryhet me SMS, në faturën mujore, duke përshkruar natyrën e shërbimeve dhe tarifave të rregulluara roaming që parapaguesi ka hequr dorë nga përdorimi për roaming në BP.
- 2.23 Për parapaguesit, të cilët kanë zgjedhur një plan tjetër tarifor nga tarifatat e rregulluara të roamingut, operatori duhet që në mënyrë periodike t'i njoftoj ata me tarifatat e reja, brenda një afati të arsyeshëm kohorë (jo më rrallë se një herë në vit).
- 2.24 Në rast se parapaguesi dëshiron të transferohet nga tarifa alternative në atë të rregulluar (default tariff), kjo duhet të bëhet pa pagesë dhe brenda një (1) dite pune.

Informacionet bazike lidhur me çmimet: Zëri, SMS dhe Të dhënat (Internet)

- 2.25 Përveç në rastin kur parapaguesi nuk dëshiron të pranojë informacion, operatorët janë të obliguar që në mënyrë automatike të dërgojnë informata bazike parapaguesit kur ai kalon në një vend të BP.
- 2.26 Edhe nëse operatori nuk aplikon një shtesë, ARKEP konsideron se klientët duhet të marrin një mesazh automatik të personalizuar. Informacioni do të dërgohet në pajisjen mobile të parapaguesit roaming, për shembull me një SMS, një e-mail ose një dritare pop-up sa herë që parapaguesi roaming hyn në ndonjë vend në BP dhe inicion për herë të parë një shërbim roaming të të dhënave në këtë vend. Ai do të ofrohet pa pagesë në momentin që klienti roaming inicion një

shërbim roaming të rregulluar të të dhënave, me një mjet të përshtatshëm për të lehtësuar pranimin dhe kuptimin e lehtë të tij.

2.27 Ky informacion bazë tarifor duhet të përfshijë informacion mbi:

- a. Deri më datë 30 Qershor 2021 aplikimin e tarifave shtesë (surcharge) mbi tarifatat vendore, përfshirë faktin se do të aplikohet mekanizmi i tarifimit në nivel vendor (përfshirë TVSH);
- b. Nga data 01 Korrik 2021 çdo politikë të përdorimit të drejtë që aplikohet ndaj klientit roaming në roaming në BP dhe tarifatat shtesë që zbatohen në tejkallim të çdo limiti sipas kësaj politike të përdorimit të drejtë;
- c. Një numër telefoni pa pagesë, nga i cili parapaguesi mund të marrë më shumë informacione të detajuara lidhur me shërbimet e rregulluara dhe jo-rregulluara të zërit, SMS dhe të dhënave;
- d. Mundësia e qasjes në numrin e emergjencës 112 (pa pagesë).

2.28 Një parapagues, i cili ka njoftuar ofruesin e tij të roamingut se ai nuk kërkon informacionin tarifor automatik, ka të drejtë në çdo kohë dhe pa pagesë për të kërkuar nga ofruesi i roamingut që ta ofrojë përsëri këtë shërbim.

2.29 Informatat e mësipërme duhet të dërgohen kur parapaguesi lidhet për herë të parë në rrjetin mobil kur kalon në njërin nga vendet e BP. Pastaj, me ndërrimin e shtetit nëse tarifatat janë të njëjta, nuk ka nevojë të njoftohet përsëri.

2.30 Operatorët gjithashtu duhet t'i informojnë parapaguesit lidhur me kyçjen automatike në "Roaming data" dhe si të bëhet shkyqja. Ofruesit e roamingut duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të mbrojtur parapaguesit e tyre nga pagesa e tarifave për roaming për shërbimet e roamingut të padëshiruar, ndërsa ndodhen në BP. Kjo përfshinë informimin e parapaguesve se si të shmanget roamingu i padëshiruar në rajonet kufitare.

2.31 Duke marrë parasysh faktin se në tregun e Republikës së Kosovës operon edhe operatori i përkohshëm mobil me infrastrukturë të kufizuar, i cili operon sipas marrëveshjes së Brukselit për Telekomunikacion, atëherë me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve Operatorët duhet të sigurojnë se gjatë kësaj faze të përkohshme, parapaguesit të mos kyçen në roaming të padëshiruar (nacional) gjatë kalimit në zonat e operimit të infrastrukturës në fjalë.

Kufiri financiar ose vëllimi i konsumit të roaming të të dhënave

2.32 Ofruesi i roamingut duhet të dërgojë një njoftim kur vëllimi i përdorimit të drejtë të shërbimit të rregulluar të roamingut të të dhënave është konsumuar plotësisht ose çdo prag përdorimi i aplikuar është arritur. Ky njoftim duhet të tregojë tarifën shtesë që do të aplikohet për çdo konsum shtesë të shërbimeve roaming të të dhënave të rregulluara nga parapaguesi roaming. Çdo parapagues ka

të drejtë të kërkojë nga ofruesi i roamingut që të ndërpresë dërgimin e njoftimeve të tilla dhe do të ketë të drejtë, në çdo kohë dhe falas, të kërkojë nga ofruesi i roamingut të ofrojë përsëri shërbimin.

- 2.33 Çdo ofrues i roamingut do t'u japë të gjithë parapaguesve të tyre roaming mundësinë të zgjedhin me vetedije dhe pa pagesë për një facilitet që siguron informacionin në kohën e duhur mbi konsumin e akumuluar të shprehur në sasi ose në monedhën euro për shërbimet e roamingut të të dhënave të rregulluara dhe të cilat garantojnë që pa miratimin e shprehur të parapaguesit, shpenzimet e akumuluar për shërbimet e roamingut të të dhënave të rregulluara gjatë një periudhe të caktuar përdorimi, duke përjashtuar MMS faturuar në bazë njësie, nuk tejkalon një limit të specifikuar financiar.
- 2.34 Për këtë qëllim, ofruesi i roamingut do të vë në dispozicion një ose më shumë kufizime maksimale financiare për periudha të caktuara të përdorimit, me kusht që parapaguesi të informohet paraprakisht për shumat përkatëse të vëllimit. Një nga këto kufizime (kufiri financiar i parazgjedhur/default) duhet të jetë jo më i madh se 50 euro (outstanding charges) për çdo periudhë faturimi mujor (pa TVSH).
- 2.35 Në mënyrë alternative, ofruesi i roamingut mund të vendosë kufijtë e shprehur në vëllim, me kusht që klienti të informohet paraprakisht për shumat përkatëse financiare. Një nga këto kufizime (kufiri i vëllimit të paracaktuar/default) do të ketë një shumë financiare përkatëse që nuk i kalon 50 euro (outstanding charges) për çdo periudhë faturimi mujor (pa TVSH).
- 2.36 Përveç kësaj, ofruesi i roamingut mund t'u ofrojë parapaguesve të tij roaming kufizime të tjera maksimale mujore të ndryshme nga at më sipër, dhe që mund të jenë më të larta ose më të ulëta se niveli 50 euro.
- 2.37 Kufijtë e parazgjedhur të përmendur në nënparagrafin e dytë dhe të tretë do të zbatohen për të gjithë parapaguesit që nuk kanë zgjedhur një limit tjetër.
- 2.38 Çdo ofrues i roamingut duhet gjithashtu të sigurojë që një njoftim i duhur t'i dërgohet pajisjes mobile të klientit roaming, për shembull me një mesazh SMS, një e-mail ose një dritare pop-up në kompjuter, kur shërbimet e roamingut të të dhënave kanë arritur 80% të kufirit financiar ose sasior të rënë dakord. Çdo klient ka të drejtë të kërkojë nga ofruesi i roamingut që të ndërpresë dërgimin e njoftimeve të tilla dhe do të ketë të drejtë, në çdo kohë dhe pa pagesë, të kërkojë nga ofruesi që ta ofrojë përsëri shërbimin.
- 2.39 Kur arrihet kufiri financiar ose sasior, pajisjes mobile të parapaguesit roaming do t'i dërgohet një njoftim. Ky njoftim duhet të tregojë procedurën që duhet ndjekur nëse parapaguesi dëshiron të vazhdojë të përdorë këto shërbime dhe koston e lidhur me çdo njësi shtesë që do të konsumohet. Nëse parapaguesi roaming nuk përgjigjet siç kërkohet në njoftimin e marrë, ofruesi i roamingut menjëherë pushon të ofrojë dhe të tarifojë klientin roaming për shërbimet e rregulluara të roamingut të të dhënave, përveç dhe derisa klienti roaming të kërkojë vazhdimin ose rinisjen e ofrimit të këtyre shërbimeve.

- 2.40 Kurdo që një parapagues roaming kërkon të zgjedhë ose të heqë një limit financiar ose sasi, ndryshimi do të bëhet brenda një (1) dite pune nga marrja e kërkesës, ai duhet të jetë pa pagesë dhe nuk do të sjellë kushte ose kufizime që u përkasin elementeve të tjerë të pajtimit.
- 2.41 Kur konsumatori zgjedh facilitetin e përmendur në paragrafin e parë të paragrafit 3, kërkesat e parashikuara në paragrafin 3 nuk do të zbatohen nëse operatori i rrjetit të vizituar në vendin e vizituar, përveç BP, nuk lejon ofruesin e roamingut të monitorojë përdorimin e shërbimeve të klientit të tij në kohë reale. Në një rast të tillë, konsumatori do të njoftohet me një mesazh SMS kur hyjnë në një vend të tillë, pa vonesa të panevojshme dhe pa pagesë, që informacioni mbi konsumin e akumuluar dhe garancia që klientit të mos kalojë kufirin e specifikuar financiar nuk janë të disponueshme gjatë roamingut në këtë shtet.

3. Shërbimet me shumicë

Tarifat me shumicë për thirrje, SMS dhe të dhëna

- 3.1 Tarifat mesatare maksimale me shumicë të Roamingut që operatorët e rrjeteve mobile në Republikën e Kosovës, në rolin e operatorit të rrjetit të vizituar, mund të aplikojnë ndaj operatorëve të rrjeteve mobile nga vendet e BP për ofrimin e shërbimit të rregulluar të thirrjeve të origjinuara në rrjetin e vizituar, përfshirë midis të tjerave kostot e origjinimit, tranzitimit dhe terminimit, shërbimit të rregulluar të SMS-ve të origjinuar në rrjetin e vizituar, të shërbimit të rregulluar të roamingut të të dhënave, nuk duhet të jenë më të larta se ato të specifikuara në tabelën në vijim.

Tabela 3: Tarifat mesatare maksimale me shumicë për shërbimet e rregulluara të roamingut Kosovë – BP (Pa TVSH).

Modeli i Tarifimit	Periudha	Thirrjet e rregulluara roaming (€/min)	SMS të dërguar (€/SMS)	Transferim i të dhënave (€/MB)
RLAH+	01 Korrik 2019	0.050	0.02	0.0250
	01 Korrik 2020	0.050	0.02	0.0150
RLAH	01 Korrik 2021	0.032	0.01	0.0077
	01 Janar 2022	0.032	0.01	0.0060
	01 Janar 2023	0.032	0.01	0.0045
	01 Janar 2024	0.032	0.01	0.0035
	01 Janar 2025	0.032	0.01	0.0030
	01 Janar 2026	0.032	0.01	0.0025

- 3.2 Tarifat mesatare maksimale të referuara në pikën 4) të këtij Vendimi janë të aplikueshme midis çdo operatori të Republikës së Kosovës dhe vendeve të BP dhe do të llogariten përgjatë një periudhe 12 mujore ose më të shkurtër sipas fazave përkatese të aplikimit të tarifave në tabelën e mësipërme.

- 3.3 Tarifa mesatare me shumicë për thirrjet e rregulluara roaming e referuar në tabelën e mësipërme për operatorët nga Kosova në rolin e rrjetit të vizituar do të llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat totale me shumicë të marra nga operatori i rrjetit të vizituar gjatë periudhës përkatëse për ofrimin e thirrjeve të rregulluara roaming me shumicë me numrin total të minutave të këtyre thirrjeve roaming të përdorura për ofrimin me shumicë të thirrjeve roaming brenda vendeve të BP gjatë periudhës përkatëse, të agreguara në bazë sekonde.
- 3.4 Tarifa mesatare me shumicë për SMS e rregulluara roaming e referuar në Tabelën e mësipërme për operatorët nga Kosova në rolin e rrjetit të vizituar do të llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat totale me shumicë për orgjinimin dhe transmetimin e SMS-ve të rregulluara roaming gjatë periudhës përkatëse me numrin total të këtyre SMS-ve të origjinuara dhe transmetuara për llogari të operatorit mobil nga vendet e BP gjatë periudhës përkatëse.
- 3.5 Tarifa mesatare me shumicë për transmetimin e të dhënave të rregulluara roaming e referuar në Tabelën e mësipërme për operatorët nga Kosova në rolin e rrjeti të vizituar do të llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat totale me shumicë për ofrimin e shërbimeve të rregulluara roaming për të dhënat gjatë periudhës përkatëse me numrin total të megabyte (MB) të të dhënave të konsumuara për ofrimin e këtyre shërbimeve për llogari të operatorit mobil nga vendet e BP gjatë periudhës përkatëse, të agreguara në bazë kilobyte (kB).

Intervalet e Tarifimit

- 3.6 Operatorët e rrjeteve mobile duhet të tarifojnë për thirrjet e rregulluara për sekond dhe nuk janë të lejuar të aplikojnë call set up fee apo kohe fillestare minimale tarifimi më të gjatë se 30 sekonda. Tarifimi për SMS dhe MMS është në bazë të njësive, ndërsa për të dhënat në Kilobyte (kB).
- 3.7 Asnjë prej operatorëve të përfshirë në roamingun Kosovë–vendet e BP nuk duhet të ndryshojë karakteristikat teknike të SMS-ve në roaming nga karakteristikat teknike të SMS-ve të ofruara në tregun vendas (1 SMS = 160 Karaktere).

Tarifat e Terminimit

- 3.8 Tarifat maksimale me shumicë të terminimit që operatorët mobil nga Republika e Kosovës mund të aplikojnë për operatorët mobil nga vendet e BP për thirrjet e rregulluara roaming të origjinuara dhe terminuara në vendet e BP nuk duhet të jenë më të larta se vlerat e dhëna në Tabelën 2.

Tabela 4: Tarifat maksimale me shumicë për terminimin e thirrjeve mobile Kosovë-Vendet e BP të lidhura me roaming (Pa TVSH).

Periudha	1 Korrik 2019 (€/min)	1 Korrik 2020 (€/min)	1 Korrik 2021 (€/min)
Tarifa maksimale	0.040	0.025	0.016

- 3.9 Operatori mobil në rolin e rrjetit të vizituar duhet të tarifojë për terminimin e këtyre thirrjeve në bazë sekonde dhe nuk është e lejuar të aplikojë call set up fee apo kohe fillestare minimale tarifimi më të gjatë se 1 sekondë.